

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 10.09.2024*

10.09.2024  
Ora 12:05

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Faslli Myrtollari, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.
- **Parti Politike:** S’ka prezent
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite tre çështje:

- Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kreshnik Myrtollari, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”.
- Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Miftar Tahir Dauti, Kryetar Bashkie në Bashkinë Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 10.09.2024*

- Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Syrja Çobo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

**Znj. P. Doçaj:** Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kreshnik Myrtollari, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”. Zoti Kreshnik Myrtollari ka depozituar formularin e dekriminalizimit, nga i cili rezulton se subjekti vetëdeklarues nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalimet e ligjit 138/2015. Në kuadër të verifikimeve paraprake, KQZ i është drejtuar Drejtorisë së Burgjeve, për gjendjen gjyqësore nga ku ka rezultuar në kthimin e përgjigjes, që për subjektin vetëdeklarues nuk ka vendime penale të formës së prerë. Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit është proceduar me verifikime të mëtejshme në formularin e vetëdeklarimit. Këtu ka rezultuar se në rubrikën 3, pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim, apo në gjykim nga ndonjë autoritet i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur me “PO”, që është proceduar në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Nisur nga këto fakte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka kaluar për verifikim më të thelluar rastin, në Prokurorinë e Përgjithshme. Kemi miratimin e rezultatit të verifikimit të këtij subjekti, nga Prokuroria e Përgjithshme, në datën 26.08.2024, nga ku rezulton se nuk ka dënime penale të formës së prerë. Nga dokumentacioni në tërësi rezulton se subjekti nuk është kandidat në Këshillin e Bashkisë Tiranë dhe subjekti propozues nuk ka marrë asnjë mandat në këtë këshill.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 10.09.2024*

Për këtë motiv, ne vlerësojmë se e ka humbur objektin dhe procedurën administrative të filluar para ditës së zgjedhjeve.

---

**Z. I. Celibashi:** Mirë, dakord. Atëhere, në këto rrethana, vendosim:

- Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues, zotin Kreshnik Myrtollari.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda tridhjetë ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.

**Vendimi nr. 176**

---

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 10.09.2024*

10.09.2024  
Ora 12:08

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Miftar Tahir Dauti, Kryetar Bashkie në Bashkinë Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.

**Parti Politike:** S’ka prezent

**Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Znj. P. Doçaj:** Në pikën e dytë të rendit të ditës kemi të bëjmë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Miftar Tahir Dauti, kryetar Bashkie në Bashkinë Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Zoti Miftar Dauti ka depozituar formularin e dekriminalizimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e dekriminalizimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që bie ndesh me parashikimet e ligjit 138/2015. Në kuadër të verifikimeve paraprake, KQZ ka kërkuar informacion nw Zyrën e Gjendjes Gjyqësore, si dhe në Zyrën e Gjendjes

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 10.09.2024*

Civile. Informacioni i marrë nga Drejtoria e Burgjeve konstaton se kandidati është në gjendje të rehabilituar. Me vendimin e datës 24.05.2023, zotit Miftar Dauti i është dhënë mandati i kryetarit të Bashkisë Has. Më pas është proceduar, pasi Instituti i Studimeve Politike i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për verifikimin e pastërtisë së figurës të kryetarit të bashkisë zotit Miftar Tahir Dauti. Nga këto konstatime Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar me shkresë për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, sepse është i vetmi organ kompetent për verifikime të plota të deklarimeve në formularin e dekriminalizimit. Në datën 16.08.2024, Prokuroria e Përgjithshme ka sjellë vendimin e rezultateve të verifikimit për subjektin zotin Miftar Tahir Dauti, nga ku rezulton se nuk ka ndryshime në gjeneralitete. Ka vetëm një saktësim të emrit pasi i është hedhur gabim në regjistrin e gjendjes civile në vitin 1974. Rezulton të jetë i dënuar me katër muaj heqje lirie, nga Gjykata e Rrethit të Beratit me vendim të formës së prerë, në vitin 1988 për kryerjen e veprës penale të “Largim pa leje nga vendi i internimit”. Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga ndonjë autoritet gjyqësor për ndonjë çështje penale. Nuk rezulton të ketë ndonjë masë sigurimi personal, as ndonjë urdhër kërkimi ndërkombëtar. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacioni dhe rezultatit të hetimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme, konstatohet se subjekti vetëdeklarues zoti Miftar Tahir Dauti, kryetar i Bashkisë Has nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit 138/2015 dhe nuk konstatohet të jetë në kushtet e ndalimit për të mos kandiduar, apo për mosvijueshmërinë e tij. Bashkëlidhur janë dhe vendimet përkatëse.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit. Atëhere, bazuar në sa u relatua, rezulton që:

- Zoti Miftar Dauti, kryetar i Bashkisë Has i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 10.09.2024*

14 maj 2023, nuk përfshihet, sikurse e thatë edhe ju, në kushtet e ndalimit dhe nuk ka ndalim për të vazhduar për të ushtruar detyrën e kryetarit të Bashkisë Has.

**Vendimi nr. 174**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 10.09.2024*

10.09.2024  
Ora 12:11

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Syrja Hysedin Çobo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.

**Parti Politike:** S’ka prezent

**Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Znj. P. Doçaj:** Pika e tretë e rendit të ditës ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Syrja Çobo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Zoti Syrja Çobo ka depozituar formularin e dekriminalizimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e dekriminalizimit, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë që bie ndesh me parashikimet e ligjit. Në kuadër të verifikimeve paraprake, KQZ i është drejtuar Drejtorisë së

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 10.09.2024*

Burgjeve për gjendjen gjyqësore. Nga Drejtoria e Burgjeve rezulton se nuk ka vendime penale të formës së prerë në ngarkim të këtij subjekti vetëdeklarues. Pasi është konstatuar se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, janë verifikuar më tej të dhënat në formularin e vetëdeklarimit, ku ka rezultuar se në rubrikën 3, pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim, apo në gjykim nga ndonjë autoritet i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur me “PO”. Është dënuar me 20 ditë burg dhe 800 euro gjobë në Gjykatën e Athinës, Greqi. Nisur nga këto konstatime, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka kaluar për verifikim më të thelluar rastin, në Prokurorinë e Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe miratimin e rezultatit të këtij verifikimit, nga ku rezulton se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Rezulton që të ketë një dënim me 3 muaj burgim dhe 1500 euro gjobë, që më pas 3 muaj dënim është konvertuar në gjobë për 4.4 euro çdo ditë brenda këtyre 3 muajve. Vepra penale për të cilën është dënuar ka të bëjë me posedimin e dokumentave të falsifikuara dhe udhëtimin me këto dokumenta. Nuk rezulton të jetë dënuar me ndonjë vendim gjyqësor jopërfundimtar dhe nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij ndonjë urdhër ndërkombëtar. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të hetimit të thelluar konstatohet se subjekti Syrja Çobo, nuk përfshihet në kushtet e veprimit të nenit 2, të ligjit 138/2015. Pavarësisht se Partia Demokratike në Këshillin e Bashkisë Berat ka fituar tre mandate, zoti Syrja Çobo nuk është në listën e fituesve, por në të ardhmen mund të jetë potencialisht kandidat për të ushtruar funksionin e anëtarit të këshillit bashkiak. Bashkëlidhur dhe projektvendimi përkatës.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Atëherë, vendosim që:

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 10.09.2024*

- Zoti Syrja Çobo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të anëtarit të këshillit bashkiak.

---

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda tridhjetë ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.

Çështje të tjera nuk kemi në rend dite, faleminderit! Seanca mbyllet!

---

**Vendimi nr. 175**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

